

TË DREJTAT DHE  
DETYRIMET TUAJA NË  
KUSHTE TË COVID-19

Lexo dhe respekto  
shëndetin publik

# 1

## TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PERSONAVE TË INFEKTUAR NGA KORONAVIRUSI COVID-19 DHE TË PERSONAVE TË CILËT KANË QENË APO DYSHOHET SE KANË QENË NË KONTAKT ME PERSONA TË INFEKTUAR ME KORONAVIRUS COVID-19

▶ Në qoftë se jeni person i infektuar me Koronavirus COVID-19 apo person që ka qenë apo dyshohet se ka qenë në kontakt me person të infektuar me Koronavirus COVID-19 në interes të shëndetit publik, do t'ju jepet masë e rreptë izolimi (karantinë) në izolim shtëpiak apo në Ente shëndetësore me kohëzgjatje prej 14-të ditë.

▶ Për llojin e masës vendos i punësuari shëndetësor pas vlerësimit të rëndësisë së fotografisë Tuaj klinike. Për masën e shqiptuar është e nevojshme të nënshkruani një deklaratë me shkrim nën përgjegjësi të plotë morale, materiale dhe penale se do të respektoni masën për të cilën do të merrni një vendim në gjuhën që e kuptoni nga Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor.

▶ Në qoftë se nuk e respektoni masën, do t'ju shqiptohet masë e rreptë izolimi (karantinë) në objekte të caktuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për të cilën Ministria e Brendshme dhe Armata e Republikës së Maqedonisë së Veriut, do të sjellin vendim.

▶ Për shkak të mosrespektimit të masës së rreptë të izolimit (karantinës) në kushte shtëpiake, jeni të detyruar të kompensoni shpenzimet e ushqimit, akomodimit dhe higjienës në ambientet e izolimit të rreptë të përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

# 2

## MASA E IZOLIMIT TË RREPTË (KARANTINË) NË OBJEKTE TË IZOLIMIT TË RREPTË TË PËRCAKTUAR NGA QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

▶ Në qoftë se jeni person i infektuar me Koronavirus COVID-19 apo person që ka qenë apo dyshohet se ka qenë në kontakt të drejtpërdrejtë me person të infektuar me Koronavirus COVID-19, pas vlerësimit të rëndësisë së fotografisë tuaj klinike nga ana e të punësuarit shëndetësorë mund t'ju caktohet masë e rreptë izolimi.

▶ Në qoftë se jeni personi që nuk ka respektuar masën e rreptë të izolimit (karantinë) në kushte shtëpiake, do t'ju shqiptohet masë e rreptë izolimi në objekte të caktuara nga Qeveria e RMV.

▶ Në qoftë se jeni shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut që dëshiron të kthehet në vend në njërin nga fluturimet humanitare të organizuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut apo në ndonjë prej vendkalimeve kufitare, do t'ju shqiptohet masë e rreptë izolimi në kohëzgjatje prej 14-të ditë.

▶ Në qoftë se ju caktohet masë e rreptë izolimi (karantinë) në objekte të caktuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut para vendosjes në cilin do nga objektet e caktuara nga Qeveria, do të nënshkruani deklaratë me shkrim nën përgjegjësi të plotë morale, materiale dhe penale se do të respektoni masën.

**DETYRIMISHT** në objektet ku do të vendoseni do të duhet të ketë dhomë të posaçme për personat që tregojnë simptoma të virusit, që do të thotë personat që shfaqin simptoma nuk duhet të jenë në të njëjtën dhomë me persona që nuk tregojnë simptoma të virusit.

# 3

## NË QOFTË SE JENI TË VENDOSUR NË NJËRIN NGA OBJEKTET E CAKTUARA TË QEVERISË, JU KENI TË DREJTË TË:

▶ Të zgjidhni menynë e ushqimit, posaçërisht llojin e ushqimit;

▶ T'ju sigurohet sjellja e ushqimit nga kuzhina në dhomë ku jeni vendosur dhe anasjelltas, si dhe mbledhja e mbeturinave dhe punëve të tjera teknike;


- ▶ Çarçafë të rinjë dhe të pastër para akomodimit në dhomë, si dhe ndërrimin i tyre duhet të bëhet në 7 ditë;
- ▶ Dezinfektim i objektit ku jeni të vendosur në çdo të 5 ditë;
- ▶ T'ju dorëzohen paketat të dedikuara për ju, çdo ditë nga ora 11-12, nga ana e personave të jashtëm (të afërmit ose miqtë). Përmbajtja e dërgesës mund të përbëhet nga sende si veshje, higjienë, postë dhe sende ushqimore e të tjera. Dërgesat duhen të jenë në kuti kartoni të mbyllura me petë nga të gjitha anët dhe të jetë i shënuar emri, mbiemri numri i dhomës dhe numri i telefonit;

## 4 SHTETAS TË RMV QË KANË NGELUR JASHTË VENDIT TË CILËT DËSHIROJNË TË KTHEHEN NË VEND

- ▶ Në qoftë se jeni shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut me qëndrim të përkohshëm jashtë vendit, mund të paraqiteni në Ambasadën më të afërt të RMV, që t'ju sigurojnë transport ajror për në aeroportin e Shkupit.
- ▶ Gjatë hyrjes në aeroportin do të nënshkruani marrëveshje me Qeverinë se pajtoheni të paguani tarifën e linjës ajrore Qeverisë së RMV dhe të nënshkruani deklaratë se pas mbërritjes në vend pajtoheni të vendoseni në karantinë shtetërore me kohëzgjatje prej 14- të ditë.
- ▶ Jeni të detyruar që brenda 15 - të ditë nga dita e hyrjes në territorin e RMV t'i paguani biletat e transportit ajror në llogarinë e Buxhetit të RMV-së.
- ▶ Gjatë kohës së transportit deri në destinacionin tuaj të akomodimit duhet të silleni në mënyrë të denjë dhe në pajtim me ligjet, ndërsa shteti është përgjegjës t'ju ofrojë një trajtim dinjitoz dhe të barabartë për të gjithë duke mos bërë diskriminim në asnjë bazë. Shpenzimet për transportin tuaj nga Aeroporti Ndërkombëtar i Shkupit në objektet e karantinës shtetërore do të janë barrë e Qeverisë së RMV-së.
- ▶ Në qoftë se jeni jashtë vendit dhe dëshironi të hyni në RMV nga njëra nga pikat kufitare të RMV-së, do t'ju shqiptohet masë e rreptë izolimi (karantinë) në kohëzgjatje prej 14-të ditë, në objekte të caktuara nga Qeveria. Shpenzimet për transportin tuaj nga vendkalimet kufitare në objektet e karantinës shtetërore, si dhe shpenzimet e ushqimit, akomodimit dhe higjienës në objekte do të janë barrë e Qeverisë së RMV-së.
- ▶ Shpenzimet e ushqimit, akomodimit dhe mbajtja e higjienës në ambientet ku zbatohet masa karantinë, për personat që hyjnë nga pikat kufitare të RMV-së, do të kompenzohen nga mjetet e Buxhetit të Qeverisë së RMV-së.

## 5 MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

- ▶ Të gjithë personat e infektuar dhe personat që janë përfshirë në masën e izolimit kanë të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë, kështu që publikimi i të dhënave të tyre personale është në kundërshtim me Rregulloret për mbrojtjen e të dhënave personale në vendin tonë. Nëse të dhënat Tuaja në mënyrë të paautorizuar janë publikuar, keni të drejtë të drejtoheni në linkun në vijim <https://dzlp.mk/mk/prizlnp> në Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, e cila është kompetente të vendosë dhe të përcaktojë shkelje të së drejtës së mbrojtjes së të dhënave personale.



СПИРИТАЛНА ПА МАИЕНЕСТО  
И НЕВОЛНОСНОТО ПОСТАПУВАЊЕ  
ОД ЗАКОНИТЕ И УСТАВНОСТИТЕ  
ЗА ЛИВУВАЊЕ ОД СЛОБОДА



Македонско здружение на млади правници

## SHoqata Maqedonase e Juristëve të Rinjë

 Donbas No.14 1-6

 02/3220-870

 [contact@myla.org.mk](mailto:contact@myla.org.mk)

 [www.myla.org.mk](http://www.myla.org.mk)



## Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut

 Naum Naumovski Borce No.83

 02/3119-073

 [helkom@mhc.org.mk](mailto:helkom@mhc.org.mk)

 [www.mhc.org.mk](http://www.mhc.org.mk)



Projekti i financuar nga  
Bashkimi Evropian

Ky publikim është përgatitur me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e ShMJR dhe në asnjë mënyrë nuk i pasqyron qëndrimet e Bashkimit Evropian.